



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER
DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. ____ Prot.

Fier, më .02.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PER PROCEDUREN E HAPUR E THJESHTUAR
ME MJETE ELEKTRONIKE**

OBJEKTI I PROCEDURËS “**Shërbim interneti**” (*Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 24 muaj*)

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
72400000-4 - Shërbimet e internetit

VLERA E FONDIT LIMIT/(*Vlera e pritshme e kontratave*):

14 710 000 (katërmbedhjetë milion e shtatëqind e dhjetë mijë) **lekë pa TVSH dhe 17 652 000**
(shtatëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy mijë) **lekë me TVSH,**

Fondi limit total (*Vlera e pritshme e kontratave*) **i ndarë sipas autoriteteve kontraktore përfituese:**

- Bashkia Fier me fond limit 9 130 000 (nente milion e njëqind e tridhjetë mijë) lekë pa tvsh dhe 10 956 000 (dhjetë milion e nenteqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë) lekë me tvsh.
- Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Fier me fond limit 540 000 (peseqind e dyzete mijë) lekë pa tvsh dhe 648 000 (gjashtëqind e dyzete e tete mijë) lekë me tvsh.
- Ndërmarrja e Pastrimit dhe Higjenës Fier me fond limit 540 000 (peseqind e dyzete mijë) lekë pa tvsh dhe 648 000 (gjashtëqind e dyzete e tete mijë) lekë me tvsh.
- Drejtoria e Artit dhe Kulturës Fier me fond limit 540 000 (peseqind e dyzete mijë) lekë pa tvsh dhe 648 000 (gjashtëqind e dyzete e tete mijë) lekë me tvsh.
- Ndërmarrja e Menaxhimit të Parqeve dhe të Gjellbërimit Fier me fond limit 180 000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa tvsh dhe 216 000 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë me tvsh.
- Ndërmarrja e Ujitjes dhe Kullimit Fier me fond limit 360 000 (treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa tvsh dhe 432 000 (katërqind e tridhjetë e dy mijë) lekë me tvsh.

- Qendra Ekonomike e Arsimit Fier me fond limit 3 420 000 (tre milion e katerqind e njezete mije) lekë pa tvsh dhe 4 104 000 (kater milion e njeqind e kater mije) lekë me tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Fier (organ qendror Bleres) ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas shtojces 10;

Argumentimi: Ky kriter u vendos bazuar ne nenin 76 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” te ndryshuar, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”*

b. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 te Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” te ndryshuar, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2.1 Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas percaktimeve te bera ne Shtojcen 8 te DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, kërkojmë të paraqiten:

2.2.1. Kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 (dy) viteve të fundit (**2023, 2024**), të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre. Nëse operatori ekonomik ofertues është në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika "c", e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "*Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar*" i ndryshuar, atëherë secili bilanc duhet të shoqërohet me akt-ekspertizen e kryer nga eksperti kontabel.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 4. *Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit¹.* Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislationit të fushës, konkretisht në ligjin nr.25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK. Kriteri i mësipërm është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga operatori ekonomik ofertues gjatë 2 (dy) viteve të fundit (**2023, 2024**) lëshuar nga Administrata Tatimore, me vlerë jo me te vogel se **10 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë që nuk tejkalon vlerën e përlllogaritur të kontratës që prokurohet). Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me piken 3 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020 "Per Prokurimin Publik" të ndryshuar, në të cilin gjejmë të percaktuar se: 3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.;* në piken 1 dhe piken 2/b të nenit 43 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku percaktohet se: Pika 1. Autoriteti/entikontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontratën, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/b: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara, se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur me sukses kontratën siç është parashikuar nga AK. Kriteri i mesipër është në përputhje dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Pika 1 dhe pika 2/b të nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, perkatesisht; Pika 2/b: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;* Duke qenë se kjo procedurë prokurimi është bazuar në vlerën e fondit limit mbi kufirin e ulët monetar dhe nën kufirin e lartë monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara me pare gëjkon se është e përshtatshme vendosja e kriterit të marzheve maksimale të përcaktuara në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; Njesia e prokurimit ka gjykuar të nevojshme përcaktimin e 2 (dy) viteve të fundit në përputhje me vlerën e fondit limit të kontratës që prokurohet.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, kërkohen **dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme**, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se **4 000 000 lekë pa TVSH** (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet) dhe që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin një nga dëshmitë e mëposhtme:

- a-** vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi **dhe të deklaruara në organet tatimore** ku shënohen datat, shumat dhe **shërbimet e realizuara**.
- b-** Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi **dhe të deklaruara në organet tatimore** ku shënohen datat, shumat dhe **shërbimet e realizuara**.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 3 të nenit 41 të VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë teknike të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet përvojës së mëparshme, se zotërojnë kapacitet dhe aftësinë teknike për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga AK.

2.3.2 Operatori duhet të jetë i licensuar në shërbimin për transmetimin e të dhënave dhe të plotësojë pikat si më poshtë:

1. Të jetë i regjistruar pranë regjistrave të AKEP për:
 - a) Shërbim interneti.
 - b) Shërbim i transmetimit të të dhënave.

Për këtë duhet të paraqitet Autorizimi i vlefshëm nga AKEP.

Argumentimi: Ky kriter i përcaktuar në nenin 41 pikë 4, gërma “a”, të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: ”Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;”. Gjithashtu ky kriter bazohet dhe në nenin 41, pikë 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar edhe në Ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimin elektronik në Republikën e Shqipërisë”. Është në të drejtën e Autoritetit Kontraktor të kërkojë garanci për realizimi me sukses të projektit, duke përfshirë kërkesat për certifikime dhe kualifikime sipas objektivit të prokurimit.

2.3.3 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të ketë fuqi minimale punetore të nevojshme për ekzekutimin e objektivit të prokurimit, me një numër prej jo më pak se **20 punonjës**, për **muajin Janar 2026**.

Shënim: Për pikën 2.3.3 më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, siç kërkohet në pikën 2.3.3, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin si më poshtë:

- a)** Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore, sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve, për **muajin Janar 2026**.
- b)** Listë pagesat e punonjësve, sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, për **muajin Janar 2026**.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në K.Punës, legjislacionin për sigurimet shoqërore (pushimet, leje e zakonshme). Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri është bërë me qëllim që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion fuqi punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit Autoriteti Kontraktor (njesia e prokurimit) ka kërkuar paraqitjen e listepageses së muajit Qershor 2022 për arsye se është muaji i fundit i maturuar duke u nisur nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Bazuar në ligjin nr.9136 datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*Neni 11 Afatet e deklaratimit dhe të pagesës*), operatorët ekonomikë kane afat të shlyejnë detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore brenda datës 20 të muajit pasardhës.

Numri 10 (dhjetë) i punonjësve është përllogaritur në bazë të pikave të lidhjeve të cilat janë në largësi të konsiderueshme me distancë fizike nga njëra - tjetra, në të cilat do të realizohet lidhja e internetit, por edhe në varësi të procesve që do të kryhen për realizimin e këtij shërbimi. (problematikave që mund të hasen gjatë realizimit të kontratës)

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij (*në listepagesën e shoqërisë për muajin Janar 2026*) të paktën 5 (**pesë**) **specialistë**, të cilët duhet të jenë inxhinierë ose specialistë të fushës së IT-së, **të pajisur me diplomë universitare në Inxhinieri Informatike ose Elektronike ose Telekomunikacion ose në degë brenda fushës së Shkencave Kompjuterike dhe Teknologjisë së Informacionit**.

Shënim: Për pikën 2.3.4 më sipër, operatorët ekonomik ofertues është e mjaftueshme të paraqesin formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr.9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të dorëzojë pranë AK, dokumentat provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sic kërkohet në pikën 2.3.4, duke dorëzuar dokumentacionin origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin **për secilin prej këtyre 5 (pese) specialistëve**, si më poshtë:

- a)** **Diplomë universitare në Inxhinieri Informatike ose Elektronike ose Telekomunikacion ose në degë brenda fushës së Shkencave Kompjuterike dhe Teknologjisë së Informacionit dhe**

b) Kontratë pune e vlefshme

Argumentimi: Ne baze te pikes 4, te nenit 77, te ligjit nr.162, date 23.12.2020 “Per prokurimin public” I ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/b, te VKM nr.285, date 19.05.2021 “Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane personelin e nevojshem te kualifikuar per realizimin me sukses te kontrates.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë të paktën pesë (5) Inxhinieri Informatike ose Elektronike ose Telekomunikacion ose ne degë brenda fushës së Shkencave Kompjuterike dhe Teknologjisë së Informacionit është thelbësore për garantimin e kapacitetit teknik të nevojshëm për të realizuar shërbimin objekt kontrate, duke qene te perfshira dhe njesite administrative ku ofrohen shërbime per qytetaret.

Përveç fazës së implementimit, kërkohet gjithashtu një ekip i mjaftueshëm teknik për të siguruar funksionimin e qëndrueshëm të shërbimit gjatë gjithë periudhës së kontratës. Projekti kërkon monitorim të vazhdueshëm, ndërhyrje 24/7 në raste emergjente, mirëmbajtje preventive, diagnostikim të problemeve të rrjetit, optimizim të performancës dhe raportim periodik teknik. Në mungesë të një numri të mjaftueshëm inxhinierësh të kualifikuar, operatori nuk do të mund të garantonte kapacitetin operacional për të mbuluar njëkohësisht të gjitha pikat ku kerkohet shërbimi dhe për të përmbushur kërkesat e SLA-ve të përcaktuara. Prandaj, prania e stafit të diplomuar siguron stabilitetin, cilësinë dhe mbështetjen teknike të nivelit të kërkuar për një shërbim te rendesishem . Kërkesa e mësipërme është percaktuar ne mbeshtetje te nenit 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, germa b), germa c) te VKM nr. 285, date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” e ndryshuar.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese:

a)certifikate te menaxhimit te cilesise ISO 9001-2015 ose ekuivalente e saj per objektin qe prokurohet , te vlefshme (*e cila duhet te jete e perkthyer ne shqip dhe e noterizuar*) e leshuar nga Organizmat e Vleresimit te Konformitetit, te cilat jane te akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga Organizmat Nderkombetare Akreditues te njohura ne Republiken e Shqiperise.

b)certifikate për menaxhimin e shërbimeve IT ISO 20000-1:2018 ose ekuivalente ose ekuivalente e saj per objektin qe prokurohet , te vlefshme (*e cila duhet te jete e perkthyer ne shqip dhe e noterizuar*) e leshuar nga Organizmat e Vleresimit te Konformitetit, te cilat jane te akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA),

c)certifikate per *Sistemin e menaxhimit te sigurise se informacionit*” ISO 27001:2022 ose ekuivalente ose ekuivalente e saj per objektin qe prokurohet , te vlefshme (*e cila duhet te jete e perkthyer ne shqip dhe e noterizuar*) e leshuar nga Organizmat e Vleresimit te Konformitetit, te cilat jane te akredituara nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga Organizmat Nderkombetare Akreditues te njohura ne Republiken e Shqiperise.

Argumentimi:

Ky kriter i percaktuar ne piken a) dhe b) eshte vendosur ne perputhje me piken 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, ne te cilen gjejmë te percaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter gjen mbështetje ne piken 1 te nenit 44 te VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik" i ndryshuar, ku percaktohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimi.*

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe ne rekomandimin e APP dhe Drejtorise se pergjithshme te Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 "Rekomandim mbi hartimin e kerkesave te cilesise".

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që si kompani kanë kualifikimet/ certifikimet e duhura organizative dhe operacionale të nevojshme për të zbatuar kontratën.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike jane të hartuara nga Grupi i Punës i ngritur nga Zv. Kryetari i Bashkise Fier, me Urdhërin nr.764 prot datë 20.01.2026 ne perputhje me nenin 4, pika 38/b, nenin 36 te ligjit nr.162/2020, "Per Prokurimin Publik" te ndryshuar, nenin 41, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"i ndryshuar. Specifikimet teknike dhe termat e references gjenden bashkengjitur DST ne SPE. Kriteret e vecanta per kualifikim qe lidhen me kapacitetin teknike jane hartuar nga grupi i punes percjelle me shkresen nr.1585/1 prot date 03.02.2026.

Shënim : Ne cdo rast kur ne specifikimet teknike dhe fotot orientuese /ilustruese mund te jete perdoruesi reference emri i ndonje marke apo emri te vecante, patente, vizatim ose tip ose origjinë ose prodhim specifik , perfshihet dhe fjala “ose ekuivalent” i saj.

Specifikimet teknike gjenden bashkengjitur DST ne SPE.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për objektin e prokurimit, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo / dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”

Njësia e prokurimit: